


Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktërës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure



Komuna Shtime
Opštine Shtimje
Municipality Shtime

02.08.2022
02/435

Në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 Mars, 2019), nenit 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4 dhe Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare, Nr. 28/04 Qershor 2008), si dhe Marrëveshjes për dorëzimin e produkteve të prokuruarra për Programin e Zhvillimit Ekonomik dhe Shoqëror Nr. Protokoli 3877/22 të datës: 05.07.2022 e lidhur në mes të MMPHI-së dhe Ambasadës Japoneze, palët e kësaj marrëveshje:

1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktërës, të cilën e përfaqëson Ministri Liburn Aliu, në tekstin vijues MMPHI

2. Komuna e Shtimes, të cilën e përfaqëson Kryetari Qemajl Aliu,

dhe

3. K.R.M. "Pastërtia" SH.A. - Ferizaj, Njësia Operative në Shtime, të cilën e përfaqëson Osman Muharremi.

lidhin:

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR DORËZIMIN E KAMIONAVE PËR MBLEDHJEN DHE BARTJEN E MBETURINAVE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi është dorëzimi i Kamionëve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktërës të Komuna e Shtimes si dhe dhënia në shfrytëzim të Kamionëve nga Komuna e Shtimes të Ndërmarrja Publike K.R.M. "Pastërtia" SH.A. - Njësia Operative në Shtime me qëllim të krijimit të një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale.

Neni 2 Objekti i Marrëveshjes

Palët përmes kësaj marrëveshjeje pajtohen që kamionët për mbledhje dhe bartje të mbeturinave të cekur në tabelën më poshtë të dhuruar si donacion nga Ambasada e Qeverisë Japoneze sipas Marrëveshjes kornizë të nënshkruar me datë 05.07.2022 në mes të Ministrit të MMPHI dhe Ambasadorit të Ambasadës së Japonisë në Kosovë, MMPHI të kalojnë në pronësi të Komuna e Shtimes dhe njëkohësisht në shfrytëzim të Ndërmarrjes Publike K.R.M. "Pastërtia" SH.A. - Njësia Operative në Shtime.

Nr:	Numri i karoseris së kamionave
01	JALFYR34KM7000008
02	JALFYR34KM7000009

Neni 3

Obligimet e Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka për obligim që:
 - 1.1. Kamionët për mbledhje dhe bartje të mbeturinave të pranuar nga Ambasada e Qeverisë Japoneze ti dorëzoj të Komuna e Shtimes;
 - 1.2. Në rast të konstatimit të keq menaxhimit të kamionëve dhe mos ofrimit të shërbimit për të cilin janë dedikuar kamionët MMPHI mund të tërheq kamionët e dorëzuar në çdo kohë.
 - 1.3. Të ofrojë dokumentacionin e kamionëve të pranuar nga donatori.

Neni 4

Obligimet e Komunës së Shtimes

1. Komuna e Shtimes, ka për obligim që:
 - 1.1. Kamionët e pranuar ti regjistroj në regjistrin e aseteve të Komunës së Shtimes;
 - 1.2. Të mos tjetërsoj të drejtën e fituar të kamionave;
 - 1.3. Të ofrojë përkrahjen e nevojshme administrative, K.R.M. "Pastërtia" SH.A. - Njësia Operative në Shtime për regjistrimin e Kamionëve;

Neni 5

Obligimet e K.R.M. "Pastërtia" SH.A. - Njësia Operative në Shtime

1. K.R.M. "Pastërtia" SH.A. - Njësia Operative në Shtime, ka për obligim:
 - 1.1. Të shfrytëzoj Kamionët për të ofruar shërbimin për mbledhje dhe bartje të mbeturinave komunale për Komunën e Shtimes;
 - 1.2. Të ruaj, mirëmbaj dhe operoj përgjegjshëm me Kamionët;
 - 1.3. Ti regjistroj dhe të kujdeset që kamionët të jenë në shfrytëzim, gjithnjë funksional dhe në gjendje operimi me qëllim që të sigurohet shërbim efikas dhe kualitativ në Komunën e Shtimes;

- 1.4. Të njoftojë Komunën e Shtimes për çdo dëmtim apo aksident i cili mund të ndodhë me Kamionët, respektivisht sektorin përgjegjës për menaxhim të mbeturinave i cili do të mbaj shënime dhe monitoroj gjendjen e pronës Komunale.

Neni 6

Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit

1. Me pëlqimin paraprak të palëve Marrëveshja e Bashkëpunimi mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. Palët mbajnë të drejtën e ndërprerjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit në rast se konstatojnë se palët nuk i kanë përmbushur obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje

Neni 7

Zgjidhja e marrëveshjes

Palët janë pajtuar në mes vete që kjo marrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim.

Neni 8

Numri i kopjeve

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është përpiluar në tre (3) ekzemplarë të njëjtë, prej të cilëve nga një (1) ekzemplarë i marrin palët nënshkruese.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë me përpikëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Liburn Aliu

Kryetari i Komunës së Shtimes

Qemajl Aliu

Menaxheri i Njesisë Operative

Osman Muharremi

Prishtinë, 28.07.2022